



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 shtator 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake

Gjykatësit të Procedurës Paraprake:

Gjykatës Nikola Giju

Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar:

Vard Ferdinanse

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), bazuar në nenet 32(3), 33(1)(a) dhe 38(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 85(1), 86(1) dhe (2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), si dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton Gjykatësin e Procedurës Paraprake.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shtator 2023, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar njoftoi Kryetaren, në përputhje me rregullën 86(1) të Rregullores, për parashtrimin e një aktakuze dhe kërkoi caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit.

II. CAKTIMI

2. Kryetarja cakton Gjykatësin e Procedurës Paraprake pas shqyrtimit të kritereve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, veçanërisht përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment.

III. KLASIFIKIMI

3. Njoftimi u dërgua në mënyrë konfidenciale dhe ky vendim mban të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, deri sa të riklasifikohet në kohën e duhur në përputhje me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

PËR KËTO ARSYE, ME KËTË VENDIM KRYETARJA ÇAKTON

Gjykatësin Nikola Giju

Gjykatës të Procedurës Paraprake pas parashtrimit të aktakuzës në këtë çështje.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 11 shtator 2023

Në Hagë,
Holandë